Quadris® 25 SC

Lënda vepruese: Azoxystrobin
PËRMBAJTJA: Azoxystrobin: 25%
Lëndë ndihmëse: 75%
Numri i regjistrimit: AL: 108/2-16.03.2012
KS: 094-0744-11-2007/06.03.2007
Formulimi: Koncentrat i suspendueshëm

FUNGICID ME VEPRIM SPECIFIK (kontakti dhe pjesërisht translaminar) QË PENGON MBIRJEN E SPOREVE, ZHVILLIMIN E MICELIT DHE PRODHIMIN E SPOREVE. KONTROLLON KËRPUDHAT ASCOMYCETES, BAZIDIOMYCETES, DEUTEROMYCETES DHE OOMYCETES

PËRDORIMI:
KULTURAT BUJQËSORE: HARDHIA

SËMUNDJET	Doza (ml/100 l ujë)	Numri i trajtimeve	Intervali i trajtimeve (ditë)
Hiri i hardhisë *(Uncinula necator)* **Nekroza e hardhisë** *(Phomopsis viticola)*	75	2	10-12
Vrugu *(Plasmopara viticola)*	100	2	12
QUADRIS kontrollon edhe këto sëmundje: **Kalbëzimi i zi i rrushit** *(Guignardia bidwelli)*, **Njollosja e kuqe e hardhisë** *(Pseudopeziza tracheiphila)* dhe **Antraknoza e hardhisë** *(Elsinoe ampelina)*. Për dozat, kohën dhe numrin e trajtimeve këshillohuni me përfaqësuesit tanë.			

MËNYRA E TRAJTIMIT: Me spërkatje, duke siguruar lagien uniforme të gjithë masës vegjetative dhe duke përdorur 250 -1000 l tretësirë spërkatëse/ha.

VËREJTJE:

1. Evitoni trajtimet kurative.
2. Të mos përdoret në fidanishtet e hardhisë.
3. Përdorni QUADRIS në programe trajtimesh duke e kombinuar me fungicide që kanë mënyrë të ndryshme veprimi.
4. Të mos bëhen më shumë se 2 trajtime me QUADRIS brenda vitit në të njejtën sipërfaqe.
5. Mos përdorni te mollët mjetet spërkatëse që kanë patur QUADRIS.

syngenta®

KOHA E TRAJTIMEVE: Kryesisht trajtime parambrojtëse. Për Hirin dhe Nekrozën trajtimi i parë bëhet me shfaqjen e gjethit të parë dhe trajtimi i dytë pas 10-12 ditëve. Për Vrugun trajtimi i parë bëhet kur kushtet janë të favorshme për shfaqjen e kësaj sëmundjeje dhe trajtimi i dytë pas 12 ditësh.

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme. Në ndonjë kultivar hardhie mund të vërehet ndonjë zverdhje e lehtë e gjetheve që ndodhën në fazën e zhvillimit intensiv, fenomen ky që zhduket pas disa ditësh dhe pa asnjë pasojë për hardhinë. Është fitotoksik tek molla,ndaj mos përdorni QUADRIS tek molla.

PËRZIHET me shumicën e pesticideve të zakonshme.

SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES: 21 ditë.

PERIUDHA E RUAJTJES: 3 vjet. Të magazinohet në vende të ajrosura, të freskëta dhe pa lagështirë, në temperaturë 0-40 ^{0} C.

MASAT PARAMBROJTËSE

-Ruajeni në ambalazhin fillestar dhe të mbyllur mirë. -Ruajeni larg ushqimeve, pijeve dhe ushqimëve për blektorinë -Gjatë punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan.-Evitoni thithjen e tretësirës spërkatëse.-Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën.-Lani duart dhe pjesët e pambuluara të trupit para se të hani, të pini lëngje dhe duhan, si dhe pas përfundimit të spërkatjes.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast thithjeje të tretësirës spërkatëse nëpërmjet frymëmarrjes largojeni të aksidentuarin nga mjedisi ku u ekspozua dhe e vini për tu çlodhur në mjedis të ngrohtë. -Në rast kontakti me lëkurën lahuni urgjentisht me ujë të bollshëm dhe sapun.- Në rast kontakti me sytë i lani urgjentisht me ujë të bollshëm duke mbajtur të hapura qëpallat të paktën 5 minuta. -Në rast gëlltitje çojeni të sëmurin urgjentisht tek mjeku dhe tregojini etiketën. Nqs i sëmuri nuk ka humbur ndjenjat, i shpëlani gojën me ujë Mos mos provokoni të vjella. Nuk ka antidot specifik. Mjekimi simptomatik.
Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.

IRRITUES

I RREZIKSHËM PËR AMBJENTIN

HELMUES PËR PESHQIT.
SHUMË HELMUES PËR ORGANIZMAT UJORE.
Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.
Atje ku ka ujra sipërfaqësore (lumenj, liqene) të lihet një brez me gjerësi 20 m i pa trajtuar.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: SYNGENTA Limited, Guildford,
Surrey GU2 7YH, UK.
Tel: + 44 1438 260 000, Fax: +44 1483 260 001.